



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 2215/2 Prot.

Tiranë, më 31.10.2023

SHTOJCA A

PROGRAMI I TRANSPARENCËS

PËR

**INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

(I RISHIKUAR)

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, është përgatitur programi i transparencës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI). Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së ILDKPKI në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës ILDKPKI ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI. ILDKPKI angazhohet të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së ILDKPKI, nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të tij në faqen zyrtare www.ildkpkj.al, si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e ILDKPKI është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa

kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi i Transparencës së ILDKPKI janë:

1. *“E drejta për informim”* është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: ILDKPKI ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e ILDKPKI dhe përkatësisht: ligji nr.9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar dhe ligji nr.60/2016, datë 2.6.2016 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, i ndryshuar.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij. Miratim nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe me Urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, ILDKPKI vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.ildkpk.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të ILDKPKI;

- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e liçencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e liçencuara;
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP-së, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- ILDKPKI, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje dixhitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;

- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga ILDKPKI.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË ILDKPKI

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	1. Vendimi i Kuvendit nr. 55/2014, i ndryshuar 2. Rregullorja e ILDKPKI http://www.ildkpkki.al/struktura/	Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare, Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari	Legjislacioni Dokumenta të ILDKPKI http://www.ildkpkki.al/organika/ http://www.ildkpkki.al/rregullore/	<i>Koordinator i/ nëpunësi i deleguar</i>
Akte ndërkombëtare	Neni 7/1/b	1. Konventa civile për korrupsionin 2. Konventa penale për korrupsionin. 3. Protokoll i Shtesë i Konventës Penale për Korrupsionin 4. Konventa e OKB - Kundër Korrupsionit	Pas botimit në fletoren zyrtare	Menuja Dokumente të Tjera http://www.ildkpkki.al/dokumenta-te-tjera/	<i>Koordinator i/ nëpunësi i deleguar</i>
Ligje	Neni 7/1/b	1. Ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar 2. Ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar Ligji nr. 60/2016 *Ligje të tjera	Pas botimit në fletoren zyrtare	Fusha e Veprimtarisë http://www.ildkpkki.al/legjislacioni/ http://www.ildkpkki.al/legjislacioni-section2/ http://www.ildkpkki.al/legjislacioni-section3/	<i>Koordinator i/ nëpunësi i deleguar</i>
Akte nënligjore	Neni 7/1/b	*Urdhërat e Inspektorit të Përgjithshëm Udhëzime të Inspektorit të Përgjithshëm	Pas botimit në fletoren zyrtare Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari	Fusha e Veprimtarisë http://www.ildkpkki.al/akte-nenligjore-section1/ http://www.ildkpkki.al/akte-nenligjore-section2/	<i>Koordinator i/ nëpunësi i deleguar</i>



				http://www.ildkpk.al/aktenenligjore-section3/ http://www.ildkpk.al/rregullore-dhe-udhezime/ http://www.ildkpk.al/udhezuesi-deklaruesve-per-kandidat/ http://www.ildkpk.al/rregullore-dhe-udhezime-sector-2/ http://www.ildkpk.al/rregullore-dhe-udhezime-sector-3/	
Dokument politikash; dokument tjetër	Neni 7/1/b	1.Strategjia për Luftën kundër Korrupsionit 2015-2020 2.Plani Veprimit	Pas miratimit nga KM (në proces)	Dokumente të Tjera Dokument a Strategjike http://www.ildkpk.al/dokumenta-strategjike/	<i>Koordinator i/ nëpunësi i deleguar</i>
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g	*Shiko më poshtë: “E Drejta për informim dhe Procedura”	Pas miratimit të procedurës nga Komisioneri DI		<i>Koordinator i/ nëpunësi i deleguar</i>
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ç	Rr. Reshit Çollaku, 1000 Tiranë. E hënë - e premte (e shtunë dhe e dielë pushim) Ora: 8:00-16:00 / Përveç festave zyrtare Koordinator për të Drejtën e Informimit 1- Olsa Brati 2-Aldona Luari	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	Kontakt ILDKPKI http://www.ildkpk.al/kontakt/	<i>Koordinator i/ nëpunësi i deleguar</i>

		<i>*(Shiko më poshtë për detaje)</i>			
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d	1.Kreu II me titull “Organet, Kompetenca dhe Struktura” i Ligjit 9049/2003, i ndryshuar 2.CV e Inspektorit të Përgjithshëm	Pas botimit në fletore zyrtare	1.Fusha e veprimtarisë Mbi deklarin e interesave private; http://www.ildkpk.al/legjisla cioni/ 2. Inspektorati i Lartë Inspektori i Përgjithshëm http://www.ildkpk.al/inspekt ori-i- Përgjithshem/	<i>Koordinator i/ nëpunësi i deleguar</i>
Mekanizmat monitorues; raporte audit; dokumentet me tregues performance	Neni7/1/ dh	1.Raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit 2.Raportet vjetore të ILDKPKI (vitet 2008-2023) 3.Rezolutat e Kuvendit për ILDKPKI (viti 2013-2023)	Menjëherë pas miratimit të aktit nga institucioni përkatës dhe marrja e tij nga ILDKPKI.	Inspektorati i Lartë Buxheeti dhe Auditimi Raport e Auditimi http://www.ildkpk.al/auditimi/ http://www.ildkpk.al/raporte- vjetore/	<i>Koordinator i/ nëpunësi i deleguar</i>
Buxheti	Neni 7/1/e	Raport “Mbi Monitorimin e Performancës së Produkteve Buxhetore të ILDKPKI” për vitin 2014-2022)	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari përkatës	Inspektorati i Lartë Buxheti dhe Auditime Buxheti i Inspektoratit të Lartë http://www.ildkpk.al/buxheti-i- inspektoratit-te- larte/	<i>Koordinator i/ nëpunësi i deleguar</i>
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	1. Ligji nr. 9643, “Për prokurimin publik” i ndryshuar. 2.Raportet financiare	Pas miratimit të procedurës/ publikimit të raportit financiar	Programi i Transparencës Gjurmë Audit Programi i Transparencës Regjistri i Kontratave të Lidhura ndër vite http://www.ildkpk.al/gjurmë- audit/ http://www.ildkpk.al/regjistri -i-kontratave-	<i>Koordinator i/ nëpunësi i deleguar</i>

				te-lidhura-ndër-vite/	
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f	Formularë deklarimi, Autorizime Udhëzime, broshura, guida, manuale Komentare dhe Publikime <i>*Shiko më poshtë</i>	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari	<p>Fusha e Veprimtarisë_M bi deklarimin e interesave private_Formulare deklarimi</p> <p>http://www.ildkpk.al/formularet-e-deklarimit/</p> <p>Fusha e Veprimtarisë_M bi deklarimin e interesave private_Udhëzues i deklaruesve per kandidat</p> <p>http://www.ildkpk.al/udhezues-i-deklaruesve-per-kandidat/</p> <p>Fusha e Veprimtarisë_M bi deklarimin e interesave private_Rregullore dhe Udhëzime</p> <p>http://www.ildkpk.al/rregullore-dhe-udhezime/</p> <p>Fusha e Veprimtarisë_Mbi parandalimin e konfliktit te interesave_Guida dhe Manuale</p> <p>http://www.ildkpk.al/guida-dhe-manuale/</p> <p>http://www.ildkpk.al/rregullore-dhe-udhezime-sector-2/</p> <p>Fusha e Veprimtarisë_Mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve</p> <p>http://www.ildkpk.al/formulare/</p>	<i>Koordinator i/ nëpunësi i deleguar</i>

				http://www.ildk-pki.al/regjistra/ http://www.ildk-pki.al/rregullore-dhe-udhezime-sector-3/ Inspektorati i Lartë_Rreth Nesh http://www.ildk-pki.al/rregullore/ http://www.ildk-pki.al/kodi-i-etikes/	
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj	ILDKPKI nuk është i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit për nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”	----	----	----
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Neni 7/1/h	Ligji për arkivat *Shiko më poshtë “Lista tip e dokumenteve me afatet e ruajtjes”	Pas botimit në fletoren zyrtare	Legjislacioni Ndhmës http://www.ildk-pki.al/legjislacioni-ndihmes/	Koordinator i/ nëpunësi i deleguar
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i	*Shiko më poshtë formatin e regjistrit të miratuar	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari	Programi i Transparencës_Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve http://www.ildk-pki.al/regjistri-i-kërkesave-dhe-përgjigjeve-të-inspektoratit-të-lartë/	Koordinator i/ nëpunësi i deleguar
Përshkrim i kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato	Neni 7/1/j	ILDKPKI nuk e ka në fushën e zbatimit të ligjit organik dhënie e ndihmës shoqërore apo subvencione për qytetarët	--	----	-----
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Formularë deklarimi, Autorizime	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari	Faqja kryesore http://www.ildk-pki.al/publiki-mi/	Koordinator i/ nëpunësi i deleguar

Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/1	Njoftime, Takimet institucionale etj.	Pas kryerjes së tyre	Njoftime për shtyp; Aktivitete dhe Bashkepunime http://www.ildkpkj.al/	Koordinator i/ nëpunësi i deleguar
-----------------------------------	------------	---------------------------------------	----------------------	--	------------------------------------

***Informacioni që bëhet publik pa kërkesë. Mënyrat e publikimit të tij.**

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në ligjin për të drejtën e informimit, konkretisht në nenin 7 të LDI.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, ILDKPKI vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit www.ildkpkj.al kategoritë e mëposhtme të informacionit:

• **Organigramën e ILDKPKI;**

- Vendimi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.48, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.55/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”;

- Tekstet e plota të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë:

a. Konventat e ratifikuara për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit:

1. Ligji nr. 8635, datë 6.7.2000 “Për ratifikimin e “Konventës Civile Për korrupsionin”;
2. Ligji nr. 8778, datë 26.4.2001 Për ratifikimin e “Konventës penale për korrupsionin” ndryshuar me ligjin nr. 9369, datë 14.4.2005;
3. Ligji nr. 9245, datë 24.6.2004 Për ratifikimin e “Protokollit Shtesë të Konventës Penale për Korrupsionin”;
4. Ligji nr. 9492, datë 13.3.2006 Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”.

b. Ligje mbi funksionimin dhe organizimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave:

1. Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
2. Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
3. Ligji nr.60/2016, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. i ndryshuar.

c. Ligje të tjera ndihmëse

1. Ligji nr. 119/2014, datë 18.9.2014 “Për të drejtën e Informimit”;
2. Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
3. Ligji nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
4. Ligji nr. 9917 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;

5. Ligji nr. 9131 "për rregullat e etikës në administratën publike", i ndryshuar;
6. Ligji nr. 152 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar;
7. Ligji nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë";
8. Ligji nr. 7905/1995 "Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
9. Ligji nr. 7895/1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
10. Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat".

d. Aktet nënligjore / Urdhrat e Inspektorit të Përgjithshëm

1. Urdhër nr. 1499, datë 12.9.2014 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të ILDKPKI-së";
2. Urdhër nr. 1406, datë 5.9.2014 "Për miratimin e Rregullores për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e funksioneve publike në ILDKPKI";
3. Urdhër nr. 1286, datë 2.9.2014 "Për përcaktimin e masave për ndalimin e pirjes së duhanit në mjediset e punës së ILDKPKI-së";
4. Urdhër nr. 1284, datë 2.9.2014 "Për miratimin e Kodit të Etikës së ILDKPKI-së";
5. Urdhër nr. 1008, datë 18.6.2014 "Për përcaktimin e kategorisë së zyrtarëve të administratës tatimore të cilët i nënshtrohen kufizimeve të nenit 32 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;
6. Urdhër nr. 1007, datë 18.6.2014 "Për përcaktimin e kategorisë së zyrëtarëve të administratës doganore të cilët i nënshtrohen kufizimeve të nenit 32 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;
7. Urdhër nr. 3528, datë 23.6.2014 "Për zbatimin e nenit 21 të ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005, i ndryshuar, për Agjencinë e Prokurimit Publike;
8. Urdhër nr. 997, datë 18.6.2014 "Për publikimin e deklaratave të interesave private";
9. Urdhër nr. 996, datë 16.6.2014 "Për miratimin e formularëve të deklaramit të interesave private";
10. Urdhër nr. 29, datë 17.3.2014 "Për ndryshim në Urdhërin nr. 620 datë 22.11.2012 "Për miratimin e llojeve të deklaratës së interesave private";
11. Urdhër nr. 28, datë 13.3.2014 "Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;
12. Urdhër nr. 27, datë 13.3.2014 "Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë", i ndryshuar.
13. Urdhër nr.1580, datë 28.07.2016, "Për gjurmët standarte të auditit në ILDKPKI"
14. Urdhër nr.1909, datë 18.10.2016, "Për një ndryshim në Urdhërin nr.40, datë 9.3.2015, "Për caktimin e masave për zbatimin e së drejtës së informimit ndaj publikut"

15. Urdhër nr.223 datë 09.05.2017, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të interesave private”
16. Urdhër nr.284, datë 09.05.2017, “Për miratimin e formularit të deklarimit të pasurive dhe interesave private”
17. Urdhër nr.475, datë 11.05.2017, “Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar edhe me ligjin nr.42/2017, datë 6.4.2017.
18. Urdhër nr.809 datë 25.05.2017, “Për përcaktimin e kategorisë së zyrtarëve të administratës tatimore të cilët i nënshtrohen kufizimeve të nenit 32, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” , të ndryshuar.
19. Urdhër nr.1222, datë 11.07.2017, “Për miratimin e formularëve dhe të regjistrave të sinjalizuesve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.
20. Vendim nr. 9, datë 24.7.2019 “Për gjurmët standarte të auditit në ILDKPKI”

e. Dokumente politikash (përgjegjës është Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Korrupsionit)

1. Strategjia për Luftën kundër Korrupsionit 2015-2020.
 2. Plani i Veprimit për zbatim të Strategjisë së Luftës Kundër Korrupsionit, 2018-2020.
- **Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës; (shiko më poshtë)**
 - **Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të ILDKPKI-së:**
Rr. Reshit Çollaku, 1000 Tiranë,
 - **Orari zyrtar i punës:**
E hënë - e premte (e shtunë dhe e dielë pushim)
Ora: 8:00-16:00 / Përveç ditëve të festave zyrtare
 - **Emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit; (Neni 2 i LDI- Koordinatori është nëpunës civil, përcaktuar në nenin 10 të LDI)**
Z. Aldona Luari dhe/ose znj. Olsa Brati
Adresë emaili: aluari@ildkpkj.al / obrati@ildkpkj.al
 - **Informacion mbi denoncimin e korrupsionit në ILDKPKI:**
Tel. pa pagesë: 0800 9999
E-mail: info@ildkpkj.al, unedenoncoj@ildkpkj.al
 - **Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit dhe strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë,**
 1. Vendimi nr. 55/2014 datë 31.7.2014 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës, dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të ILDKPKI-së”, i ndryshuar
 2. Rregullore e Brendshme ILDKPKI (shiko aktet nënligjore).
 - **Përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;**

1. Kreu II me titull “*Organet, Kompetenca dhe Struktura*” ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar;
 2. CV (Curriculum Vitae) e Inspektorit të Përgjithshëm gjendet në faqen zyrtare të ILDKPKI.
- **Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi ILDKPKI:**
 1. Raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.
 2. Raportet vjetore të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (vitet 2008-2018).
 3. Rezolutat e Kuvendit “*Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave*” (viti 2013-2018).
 - **Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.**
 1. Raport “*Mbi Monitorimin e Performancës së Produkteve Buxhetore të ILDKPKI për vitin 2014-2018*”;
 2. Raport “*Monitorimi i Produkteve Viti 2014-2018*”;
 3. Raport “*Monitorimi i Buxhetit 9-mujori 2014-2018*”;
 4. Format i “*Monitorimi i produkteve 9-mujori i Buxhetit 2014-2018*”;
 5. Raport “*Monitorimi i Buxhetit 6-mujori 2014-2018*”;
 6. Format i “*Monitorimi i produkteve 9-mujori i Buxhetit 2014-2018*”.
 - **Informacion për procedurat e prokurimit publik (ILDKPKI nuk kryen proceduara në bazë të ligjit nr. 125/2013 “*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*”).**
 1. Lista e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
 2. Ligji nr. 9643, datë 20.12.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe buletinet e APP-së për të gjitha kontratat e lidhura.
 - **Informacion për shërbimet apo informacionin që ILDKPKI jep në faqen e internetit:**
 1. Misioni dhe qëllimi i krijimit të institucionit;
 2. Udhëzime, broshura, guida, manuale:
 - a. Udhëzim nr.1, datë. 27.6.2014 “*Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike*”;
 - b. Guidë mbi deklarimin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesave;
 - c. Guidë për konfliktin e interesave në qeverisjen vendore;
 - d. Guidë për konfliktin e interesave në administratën doganore;
 - e. Guidë për konfliktin e interesave në administratën tatimore;
 - f. Manual shpjegues dhe trajnimi mbi rolin e autoriteteve përgjegjëse në parandalimin e kontrollin e konfliktit të interesave;
 - g. Manual 1 “*Shpjegues dhe trajnimi mbi parandalimin e konfliktit të interesave*”;

- h. Manual 2 “Mbi parandalimin e Konfliktit të Interesave në prokurimet publike”;
 - i. Manuali 3 “Shpjegues dhe trajnimi mbi parandalimin e konfliktit të interesave në pushtetin vendor”.
 - j. Udhëzimi dhe Formulari i Deklarimit për kandidatët në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.
- 3. Komentarë dhe Publikime në interes të Autoriteteve Përgjegjëse dhe Zyrtarëve:**
- a. Komentar ligjor 1;
 - b. Komentar ligjor 2;
 - c. Komentar ligjor 3;
 - d. Komentar ligjor 4.
- 4. Informacion ndihmë për zyrtarët:**
- a. Guidë mbi shmangien e konfliktit të interesave;
 - b. Si të plotësoj saktë dokumentin zyrtar “*Deklaratë e Interesave Private Pasurore*”;
 - c. Afatet e deklaramit të interesave private;
 - d. Formularë deklarimi (gjenden edhe si shtojca të këtij programi transparence):
 - Para Fillimit të Detyrës
 - Periodike / Vjetore
 - Pas Largimit nga Detyra
 - Me kërkesë
 - e. Subjektet deklaruese në bazë të nenit 3 të ligjit nr. 9049 “*Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive...*”;
 - f. Autorizimi dhe Deklarata për Konfliktin e Interesave:
 - Autorizimi
 - Formular i deklarimit rast për rast të konfliktit të interesave
 - g. Formularë të Sinjalizimit të Brendshëm,
 - h. Formularë të Sinjalizimit të Jashtëm,
 - i. Formularë Kërkesë për Mbrojtje nga hakmarrja
 - j. Regjistër i kërkesës për mbrojtjen nga hakmarrja,
 - k. Regjistër i sinjalizimit të brendshëm në njësinë përgjegjëse në organizatë,
 - l. Regjistër i sinjalizimit të jashtëm.
- 5. Informacion për punonjësit e ILDKPKI:**
- a. Kodi i Etikës;
 - b. Rregullore e Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesave;
 - c. Rregullore e Brendshme për ILDKPKI;
 - d. Rregullore për hetimin Administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në ILDKPKI;
 - e. Rregullore për hetimin Administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në ILDKPKI
- 6. Njoftime për shtyp mbi veprimtarinë e ILDKPKI:**
- a. Takime dhe vizita pune me institucione vendase dhe të huaja;
 - b. Marrëveshje Bashkëpunimi të lidhura (Kopje të tyre);

- c. Njoftime masash administrative dhe kallëzimesh penale ndaj subjekteve deklaruese, shkelës të legjislacionit në fuqi.

Të dhënat që do të mbahen në regjistrin për të drejtën e informacionit të ILDKPKI
ILDKPKI administron të dhëna që janë në kompetencë të saj dhe që kanë të bëjnë me deklarimin e pasurive dhe konfliktin e interesave dhe i vendos ato në dispozicion të kërkuësve me kërkesë, konform rregullave të përcaktuara në ligj. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka vendosur standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit, konkretisht në përputhje me elementët që përcaktohen në LDI. Regjistri për të drejtën e informacionit në ILDKPKI përmban këto të dhëna:

- 1- Numri rendor i kërkesës;
- 2- Data e regjistrimit të kërkesës;
- 3- Objektin e kërkesës;
- 4- Data e kthimit të përgjigjes;
- 5- Statusi i kërkesës (pranuar/refuzuar);
- 6- Tarifa (me pagesë/pa pagesë).

- **Informacioni që bëhet publik me kërkesë. Mënyrat e publikimit të tij.**

Në përputhje me ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë*", i ndryshuar, neni 34 "*Publikimi*", ILDKPKI bën publike deklaratat e interesave private të zyrtarëve apo të zgjedhurve, me kërkesë. Ky informacion nuk bëhet automatikisht publik nga institucioni dhe nuk publikohet në faqen e tij zyrtare pasi Gjykata Kushtetuese në Vendimin nr.16, datë 11.11.2004, e ndalon shprehimisht këtë formë publikimi. Publikimi i deklaratave të subjekteve deklaruese kryhet në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar, dhe pasi të jenë redaktuar/ fshirë pjesët konfidenciale të saj dhe të dhënat personale.

- Procedura e publikimit dhe dhënies së deklaratave kryhet sipas Urdhrit nr. 997, datë 18.6.2014 "*Për publikimin e deklaratave të interesave private*", miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm

- **E Drejta për informim dhe Procedura.**
- **Kërkesa për informim:**

Kërkesa e palës së interesuar për informacion, bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, nëpërmjet shërbimit postar ose me postë elektronike, duke paraqitur qartë identitetin e kërkuësit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kur kërkesa dorëzohet dorazi apo nëpërmjet shërbimit postar, duhet të përmbajë elementët e përcaktuar në pikën 4 të nenit 11 të LDI, ku përfshihen: emri dhe mbiemri i kërkuësit; adresa postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni; përshkrimi i informacionit që kërkohet; formati në të cilin preferohet informacioni; dhe çdo e dhënë që kërkuësi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

- **Konstatimi i kompetencës ose moskompetencës së ILDKPKI:**

Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen si rregull, nëpërmjet dhënies pa pagesë të informacionit nga ILDKPKI, apo nëpërmjet informacionit të ofruar në faqen zyrtare të internetit: www.ildkpk.al

Çështja e përcaktimit të kompetencës për trajtimin e kërkesës varet nga:

1. Objekti i kërkesës;
2. Natyra e të dhënave që kërkohen;
3. Mundësia e ILDKPKI për ta përpunuar apo interpretuar kërkesën;
4. Përcaktimi konkret i departamentit kompetent për të;
5. Vendndodhja fizikisht e dokumentit që përmban këtë informacion.

• **Përgjigjet dhe Vendimet e ILDKPKI**

Përgjigjet dërgohen me postë ose merren dorazi brenda afatit 10 (dhjetë) ditor të përcaktuar në LDI. Për shkaqe të përcaktuara, ILDKPKI rezervon të drejtën të zgjasë me vendim afatin e dhënies së informacionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi me 5 (pesë) ditë.

• **Ankimet**

Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë KDIMDP-së, bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:

- a) Ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
- b) Ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

Programi i transparencës së ILDKPKI, si dhe skema e publikimit hyjnë në fuqi menjëherë.

• **LISTA TIP E DOKUMENTEVE ME AFATET E RUAJTJES**

LISTA TIP E DOKUMENTEVE ME AFATET E RUAJTJES		
NR	EMËRTIMI	AFATI I RUAJTJES
1.	Dokumente për krijimin, organizimin, riorganizimin dhe funksionimin e ILDKPKI: - Vendime - Rregullore	Ruhen gjithmonë
2.	Dokumente të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm. - Udhëzime - Vendime - Urdhra - Autorizime - Udhëzues	Ruhen gjithmonë
3.	Dokumente të veprimtarisë së punës të ILDKPKI - Ligje - Plane - Strategji - Raporte - Marrëveshje	Ruhen gjithmonë

4.	Dokumente mbi kontrollin e Deklaratave të Pasurisë dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesave. - Urdhra - Proces verbale - Relacione (Akt kontrolli) - Vendime	Ruhen gjithmonë
5.	Korrespondencë e thjeshtë	Ruhen 5-10 vjet
6.	1. Formular të Deklarimit të Interesave Private (Pasuritë) - Para Fillimit të Detyrës - Periodik/Vjetor - Pas Largimit nga Funkzioni - Me Kërkesë	Ruhen 10 vjet
7.	Korrespondencë e thjeshtë me subjekte publik dhe privat kur njoftojnë; - Sensibilizuese - Plotësuese - Informacione	Ruhen 5-10 vjet
8.	Korrespondencë e thjeshtë për - Dokumente të hartuara - Kërkesë për dhënie mendimi - Mendime të ardhura	Ruhen 5-10 vjet
9.	Projekte ligjore dhe nën ligjore të ardhura	Ruhen gjithmonë
10.	Korrespondencë e thjeshtë për; - Dhënie mendimi - Kthim përgjigje	Ruhen 5-10 vjet
11.	Dokumente për trajnim vazhdues: - Lista e seminareve - Shkresa për caktim personi - Komunikimi në vazhdim për persona të caktuar.	Ruhen 5-10 vjet
12.	Dokumente për rregulloren e brendshme tip, korrespondencë e thjeshtë.	Ruhen 5-10 vjet
13.	Korrespondencë e thjeshtë për marrëdhëniet me publikun. - Ankesa - Kërkesa	Ruhen 5-10 vjet
14.	- Dokumente lidhur me asistencën teknike dhe shkëmbimin e përvojës me vendet e tjera. - Korrespondencë e thjeshtë.	Ruhen gjithmonë Ruhen 5-10 vjet
15.	- Dokumente për strukturën organizative, kategorizimin dhe fondin e pagave. - Vendime, udhëzime, organika, pasqyra, borderotë e pagave, libri i pagave, propozime të miratuara. - Propozime të pa miratuara, korrespondenca e thjeshtë.	Ruhen gjithmonë Ruhen 5-10 vjet
16.	Dokumente për hartimin dhe zbatimin e buxhetit. Evidencat përmbledhëse, ligje, vendime, projekt buxheti, detajimi i buxhetit, situacioni dhe evidencat periodike, përfshirë në përmbledhëse, korrespondencë e thjeshtë.	Ruhen gjithmonë Ruhen 5-10 vjet
17.	Dokumente të thesarit.	Ruhen gjithmonë
18.	Dokumente për probleme të kontabilitetit.	Ruhen gjithmonë

	<ul style="list-style-type: none"> - Vendime - Udhëzime - Bilance vjetore - Përmbledhëse - Bilance dhe evidencë periodike dhe vjetore, përfshirë dhe korrespondencë e thjeshtë. 	Ruhen 5-10 vjet
19.	<ul style="list-style-type: none"> - Dokumentacion mbi sigurimet shoqërore. - Ligje , vendime, udhëzime, raporte, evidenca, relacione përmbledhëse. - Evidenca e relacione periodike, përfshirë përmbledhëset korrespondencë e thjeshtë. 	Ruhen gjithmonë Ruhen 5-10 vjet
20.	<ul style="list-style-type: none"> - Dokumente për treguesit e pagave, rritja reale e pagës mesatare mujore, pagat sipas grup profesioneve, ligje, vendime, evidenca statistikore. - Evidenca, informacione të përfshira në përmbledhëse , korrespondencë e thjeshtë. 	Ruhen gjithmonë Ruhen 5-10 vjet
21.	<p>Dokumente emërimi, masa ndëshkimore.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendime - Urdhëresa - Kërkesa, ankesa, evidenca periodike, - korrespondencë e thjeshtë. 	Ruhen gjithmonë Ruhen 5-10 vjet
22.	<ul style="list-style-type: none"> - Dokumente për inventarin fizik të mjeteve kryesore si dhe materialeve të përdorimit të përditshëm. - Evidenca statistikore, libri përmbledhës, udhëzimet e dhëna si dhe raportet e ndryshme. - Evidencat periodike që janë përmbledhëse, dokumentacioni i përditshëm. 	Ruhen gjithmonë Ruhen 5-10 vjet
23.	<ul style="list-style-type: none"> - Dokumente për kontroll –revizionin financiar. <p>Akte kontrolli (për probleme të rëndësishme, përgjithësime, raporte, relacione e informacione periodike përfshirë. Përfshirë në përmbledhëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Korrespondencë e thjeshtë. 	Ruhen gjithmonë Ruhen 5-10 vjet
24.	<ul style="list-style-type: none"> - Biblioteka - Historiku - Raporte të autoriteteve të huaja. - Materialë nga autoriteteve të huaja. - Raporte nga institucione të tjera. - Botime. 	Ruhen gjithmonë
25.	Dosje personale të personelit.	Ruhen gjithmonë

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, ILDKPKI vendos në dispozicion të publikut në faqen e internetit www.ildkpkj.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën

e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, duke përfshirë dhe ILDKPKI-në, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.